

Hasan Lika: Nje fitore per tifozet e kuq

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 09 Nentor 2013 20:33



I kenaqur nga sukesi, treneri i Partizanit Hasan Lika ne perfundim te ndeshje ka gezuar bashke me skuader. E ka quajtur sin je fitore qe do te riktheje qetesine tek skuadra e tij dhe si te tille ja ka dedikuar tifozve. “Per ne ishte e rendesishme te merrnim kete sukses. Skuadra veproi mire ne fushe dhe aritem te shfrytezonim lojen e mire dhe rastet e krijuara. E dinim qe nuk do te ishte e thjeshte dhe nuk ishte e tille. Megjithate tani qe ja dolem fituam qetesine per te punuar te qete per periudhen e pushimit dy javore”, ka deklaruar treneri Lika.